



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:124638
Datë: 09.10.2024
Numri i dokumentit: 06275012

2024:073916

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Pergjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike të paditësit J.C nga fsh. G.....-K.Kaçanik, me nr. personal, të cilin e përfaqëson avokat Visar Musa nga Ferizaj, kundër të paditurës I....“P....” SHPK me seli në Ferizaj, me NUI, të cilën e përfaqëson drejtori menaxhues Y.K, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “KËRVESHI & PARTNERS” me seli në Prishtinë, rr. B, C15/10, nr. 2, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 16490 euro, pas shqyrtimit kryesor në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më dt. 09.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit J.C nga fsh. G.....-K.Kaçanik dhe **DETYROHET** e paditura I.... “P....” SHPK me seli në Ferizaj, me NUI, që sipas përgjegjësisë të ndarë prej 90% të përgjegjësisë primare së të paditurës dhe 10% të përgjegjësisë sekondare të paditësit, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material lidhur me aksidentin në vendin e punës të dt. 15.12.2018, t’ia paguaj shumat si në vijim:

- **në emër të dëmit jomaterial (satisfakcion):**
- për shkak të dhimbjeve fizike të përjetuara shumë prej 4,000 €;
- për frikën e përjetuar..... 2,000 €;
- për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë 5% 3,200€;

- **në emër të dëmit material:**
- për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj..... 150.00 €;
- për ushqim të përforcuar..... 250.00 €;

Gjithsej shuma; **9,600€ (nëntë mijë e gjashtëqind euro).**

II. DETYROHET e paditura I... “P...” SHPK me seli në Ferizaj, me NUI, që paditësit J.C, shumat e gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguajë së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt. 09.10.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.26.02.2019, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit J.C dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 3600,00€, në emër të frikës shumën prej 800,00 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 1800,00€ si dhe kërkesa lidhur me kompensimin e shpenzimeve të rehabilitimit klimaterik, në shumën prej 690,00€.

IV. DETYROHET e paditura I... “P...” SHPK me seli në Ferizaj, me NUI që t’ia paguaj paditësit J.C, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1380,00€ (njëmijë e treqind e tetëdhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Rrjedha e çështjes

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr....., të dt. 24.05.2021, ka vendosur I. Pjesërisht Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit; J.C nga fshati G....., komuna e Kaçanikut, kundër të paditurës; I... “P...” Sh.P.K me seli në Ferizaj, si e bazuar. II. Obligohet e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit si pasojë e lëndimit në punë më 15 dhjetor 2018, të i’a kompensoj shumën e përgjithshme prej 5.200 € (pesëmijë e dyqind euro) dhe atë:Për zvogëlim të përgjithshëm të aktivitetit jetësor 3500 €, Për dhimbje fizike 1000 €, Për frikën e përjetuar 700 €, me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 964.00 € (nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër euro) të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, në të kundërtën ky aktgjykim mund të shërbejë për inicim dhe zhvillim e procedurës përmbarimore. III. Refuzohet e pa bazuar pjesa tjetër e

kërkesëpadi së paditësit, në lartësi prej 11.290 € (njëmbëdhjetëmijë e dyqind e nëntëdhjetë euro) përtej shumës së aprovuar si dhe kërkesa për shpenzime të procedurës përtej shumës së aprovuar në lartësi prej 1608 € (njëmijë e gjashtëqind e tetë euro).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr.5487/21, të dt. 22.02.2024, ka vendosur I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës I... "P..." SHPK me seli në Ferizaj, PRISHET pika e I-rë dhe e II-të e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr....., të dt. dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim. II. Pika e III-të e dispozitivit të të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr....., të dt. mbetet e pashqyrtuar.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi J.C përmes të autorizuarit të tij av. Visar Musa nga Ferizaj, me datë 26.02.2019 ka paraqitur padi për kompensim dëmi material dhe jo-material, kundër të paditurës. Paditësi, përmes të autorizuarit të tij në padi, në riprocedurë gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe precizimit të kërkesëpadi së, duke theksuar se paditësi me datë 15.12.2018 deri sa ka qenë në vendin e punes ne kompaninë "P..." e cila ka patur kontratë të punës me të paditurën, deri sa në ora 21:30-22.00 deri sa kishte shkuar ne depo per te marr produkte te cilat nevoiten per furnizim te marketit, ashtu qe paditesit i ishte nevoitur paletari i rrymes per te marr produktet qe nevoiten, mirepo ne ate moment poletarin e kishte marr një punëtor me emrin Korab të nxënë me produkte tjera, për të liruar këtë paletar duhej ato produkte ti vendosim në raftin e tyre të lartë, ashtu që më është dashur të ngjitem në lartësi, ashtu që pas pak vie edhe kolegu Florenti dhe mundohet të ngjitet në lartësi nëpër rafte për të më ndihmuar mua, ashtu që deri sa kam qenë duke u ngjitur në raft paleta rrëshqet sepse ishte e pasigurt në atë moment paditësi bie nga lartësia duke pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja. Ka shtuar se mbetem në tërësi pranë padisë edhe kërkesëpadi së dhe parashtresës për precizimin e padisë dhe kërkesëpadi së të dorëzuar më fjalë përfundimtare, si dhe shtojmë shpenzimet procedurale për ekspertin gjyqësor nga mbrojtja në pune 200 euro si dhe për dy seanca gjyqësore secila nga 270.4 apo 540.80 euro për këto dy seanca të mbajtura, si dhe shtesën e taksës gjyqësore në shumën prej 80 euro.

E paditura përmes të autorizuarit të saj "KËRVESHI & PARTNERS" me seli në Prishtinë, në riprocedurë gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadi në e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, ku përveç

tjërash ka theksuar: Se për të paditurën nuk është kontestues se paditësi është lënduar derisa ka qenë duke punuar tek e paditura, mirëpo ka theksuar se lëndimet që i ka pësuar paditësi, janë lëndime të shkaktuara me fajin e tij. Ka theksuar se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura në pozitën sektorist në sektorin e ushqimeve dhe se detyrat e tij sipas kontratës ka qenë të kujdeset për çmimet e produkteve, pastërtinë, ndryshimin e produkteve në raft si dhe përcjelljen e afateve të produkteve, e që në këtë drejtim ka theksuar se paditësi ka vepruar në kundërshtim me detyrat e punës pasi që i njëjti ka shkuar në depo dhe është ngjitur mbi ‘’lugë’’ të paletarit për të vendosur produkte. Më tej, e paditura ka cituar dispozitën e nenit 21 par.1 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në të cilën dispozitë përcaktohet detyrimi i të punësuarit që të kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e vet, me ç’rast paditësi ka rënë në kundërshtim me këtë nen. Përveç tjërash ka elaboruar edhe raportin zyrtar të Inspektoratit të Punës, duke theksuar se ka gjetur vetëm dy shkelje nga ana të paditurës dhe atë: paditësi nuk ka qenë i pajisur me rroba pune duke u shkelur neni 13 par.1 nëpar. 1.16 të LSSH-së dhe po ashtu e paditura ka bërë shkelje të nenit 23 par.1 të të njëjtit ligj me arsyetimin se e paditura në momentin kur ka ndodhë lëndimi në punë ka qenë e obliguar që menjëherë ta njoftojë Inspektoratin e Punës, e që për këto dy shkelje Inspektorati i Punës në Ferizaj, përmes vendimit të datës 22 janar 2019, të paditurës i ka shqiptuar gjobë në lartësi prej 1.500 €. Në këtë drejtim ka theksuar se në lidhje me raportin zyrtar të Inspektoratit të Punës është shumë me rëndësi që të bëhet dallimi thelbësorë që ka të bëjë me bazën e kërkesëpadisë, duke shtuar se raporti zyrtar nuk e ka nxjerrë përgjegjëse të paditurën lidhur me shkaktimin e lëndimit në punë të paditësit. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa të obligohet paditësi që të paditurës t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës.

Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijojnë: kontratën për themelimin e marrëdhënies së punës e datës 01.10.2018 e nënshkruar në mes të palëve ndërgjyqëse, Aneksi i kontratës së punës e datës 01.10.2018 e nënshkruar në mes të palëve ndërgjyqëse, Raporti Zyrtar me numër 04/19 i përpiluar nga Inspektoriati i Punës në Ferizaj me datë, Fletëlëshimi me Epikriëz e lëshuar nga QKUK-së Klinika e neurokirurgjisë e datës ... për paditësin, Raporti Mjekësor për paditësin, kupona fiskal ftesë e datës flet kthesa e datës, Kopjet e transkriptove të komunikimit elektronik në mes të autorizuarit të paditurës dhe paditësit të datave 21 dhe 23 shkurt 2019,

Vendimi për kompensim të pushimit mjekësor të datës ..., e lëshuar nga paditësja për paditësin, Lista e pagave mujore për periudhën kohore prej 31 korrik deri me datë ..., kërkes për kompensimin e dëmit të pësuar në vend të punës (pa datë), Ekspertizë mjekësore e përpiluar nga eksperti Dr: E.Xh. I. – ortoped – tramatolog e datës ..., Ekspertizë mjekësore e përpiluar nga eksperti Dr: M. A - psikiatër e datës ..., Aktvendimi për ndërprerjen të punës për shkak të mungesës së pa arsyeshme në punë e datës .. dhe ekspertiza nga mbrojtja dhe siguria në punë e dt. ... e ekspertit H.O. nga Prishtina.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt jokontestues se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të caktuar tek e paditura, i caktuar në vendin e punës Sektor / Ushqimor në njësinë punuese P... 14 me adresë në rr. Ahmet Kaqiku 1. Po ashtu gjykata gjeti se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi përderisa ishte duke punuar tek e paditura, si pasojë e aksidentit në punë ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Nuk ka qenë kontestues fakti që e paditura i ka bërë ftesë paditësit të paraqitet tek e paditura, në zyrën e burimeve njerëzore dhe ti sjellë të gjitha raportet mjekësore lidhur me shpenzimet e kurimit me qëllim të kompensimit të atyre shpenzimeve, gjë që vërtetohet nga ftesa e dt. 13.02.2019. Poashtu seanca e dt. 22.02.2021 është shtyrë me propozimin e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse me qëllim të arritjes së pajtimit gjyqësor ose rrugëve tjera alternative.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet, nëse paditësi ka të drejtë në kompensim për shkak të lëndimeve të marra tek e paditura, ashtu që në njërën anë pala paditëse pretendon se i takon një kompensim i tillë, ndërsa e paditura pretendon se nuk i takon kompensimi, ngase e paditura nuk mund të mbahet përgjegjëse, për këtë në thelb palët kishin pikëpamje diametralisht të kundërta.

Me leximin e Raportit Zyrtar të Inspektoratit të Punës nr. 04/19, të datës 14.01.2019, vërtetohet se janë konstatuar shkeljet: - Paditësi nuk ishte i pajisur me rroba pune dhe këpuca të punës e që është në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.16 të Ligjit për Siguri dhe Shëndetit në Punë (në tekstin e mëtejshëm LSSH); - Mjeti-paletari i cili ishte përdorur për kryerjen e punëve për ta paluar mallin nuk ishte i përshtatshëm për kryerjen e punëve në lartësi,

ashtu që punëdhënësi (e paditura) nuk e ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 14 paragrafi 3 të LSSH-p-së. - Konstatimi i gjendjes faktike nga ana e Inspektore së Punës është bërë e pa mundur sepse moslajmërimi i menjëhershëm i rastit të lëndimit i ka pamundësuar Inspektore së Punës shikimin dhe analizimin e vendit të ndodhjes së aksidentit në punë me pasoja lëndim i të punësuarit - Punëdhënësi nuk ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 23 par.1 të LSSH-p-së, në të cilën dispozitë përcaktohet se në rastet kur ndodh aksidenti me pasoja lëndimi apo vdekjen e të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar ta lajmërojë menjëherë Inspektoratin e Punës, punëdhënësi nuk e kishte lajmëruar rastin e aksidentit i cili kishte ndodhur më 15 dhjetor 2018 në biznesin ‘‘P...’’ SH.P.K në Ferizaj në rrugën ‘‘Ahmet Kaçiku’’.

Gjykata duke vepruar në kuptim të vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktvendimin AC.nr....., të datës ... të Gjykatës së Apelit e Kosovës, të cilat janë të obligueshme për këtë gjykatë në kuptim të nenit 199 të LPK, ka nxjerrur provën përmes ekspertizës nga mbrojtja dhe siguria në punë e dt. ..., nga eksperti Dr. sc. H.O. nga Prishtina.

Eksperti nga mbrojtja dhe siguria në punë Dr. sc. H.O, në ekspertizën me shkrim të datës 10.07.2024, ka dhënë mendimin e tij profesional lidhur me shkaqet dhe përgjegjësinë e lëndimit në punë të punëtorit – paditësit. Përgjegjësia primare i takon punëdhënësit kurse përgjegjësia sekondare i takon punëmarrësit J.C. Lëshimet e palës së paditur (punëdhënësit), I.1. Nuk ka ndërmarrë masa prandaluese për të krijuar kushte për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarit dhe ambientit të punës për punëmarrësit e tij sipas Ligjit 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë (neni 6), I.2. Nuk e ka bërë vlerësimin e rrezikshmërisë së vendit të punës (neni 16). Nuk ka dokument me të cilin vërtetohet se vlerësimi i rrezikshmërisë është bërë edhe në kohën në të cilën ka ndodhur aksidenti më dt. 15.12.2018, I.3. Nuk ka ofruar dëshmi se ka ndërmarrë masa për parandalimin e rrezikut në punë për vendin e punës ku ka ndodhur aksidenti; përkatësisht për vendin e punës sektor/ushqimor (neni 7), I.4. Nuk e ka informuar punëmarrësin (punëtorin) për sigurinë dhe shëndetin në punë (duke pasur parasysh rreziqet dhe masat mbrojtëse për vendin e punës (neni 18), I.5. Nuk ka ofruar dëshmi për trajnimin e punëmarrësit për siguri dhe shëndet në punë (neni 20), I.6. Nuk e ka informuar organin kompetent për aksidentin (nuk ka dëshmi se është njoftuar Inspektorati i Punës për lëndim në punë) (neni 23, par. 1), I.7 Nuk ka dëshmi se pajisjet personale mbrojtëse, të punëmarrësit kanë qenë adekuate për vendin e punës, I.8. Nuk i ka të përshkruara detyrat e punës për pozitën e punës në të cilën është aksidentuar paditësi, I.9. Mjeti i punës, në këtë rast pirunjeri elektrik që është përdorur për të palosur mallin nuk është mjet adekuat për përdorim në lartësi më të mëdha se 3.15 m. Njëherit

ky mjet i punës (pirunjer) nuk guxon të përdoret për ngritjen e njerëzve. 5.II. Lëshimet e palës paditëse (punëmarrësit). II.1. Nuk ka pasur kujdes të duhur për sigurinë dhe shëndetin e vet gjatë kryerjes së detyrave, edhe pse nuk ka pasur vlerësim të rrezikshmërisë dhe përshkrim të detyrave të punës (neni 21, par. 4.)

Gjykata në kuptim të nenit 362.1 të LPK e ka ftuar ekspertin nga mbrojtja dhe siguria në punë Dr. sc. H.O nga Prishtina në shqyrtim gjyqësor të dt. 10.09.2024 për të dhënë sqarime shtesë, ku palët e kanë pasur mundësinë të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime shtesë nga ana e ekspertit.

Ekspertët Dr. Enver Ismaili, ortoped-traumatolog në ekspertizën e tij ka konstatuar se si pasojë e aksidentit në punë, paditësi ka pësuar lëndime trupore sipas diagnozës: Thyerje lineare mediasagitale e kockës frontale, Gjakderdhje në regjionin frontal të dy anshëm të kokës, Ndrydhje hemorragjike e regjionit fronto-bazal të dy anshëm më tepër majtas, Sinusi Frontal i majtë i mbushur me gjak, Gjakderdhje nënlëkurore e regjionit frontal të kokës, Edemë e shuplakave dhe të parakrahëve. Vlerësimi mjekësor 1. Natyra e lëndimit, këto lëndime kualifikohen si lëndime të rënda trupore që kanë shkaktuar zvogëlim të përhershëm të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Në momentin e lëndimit këto lëndime trupore nuk e kanë rrezikuar drejtpërdrejt jetën e të lënduarit. 2. Zvogëlimi i përhershëm të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Në shkallë prej 5 %. Ky Zvogëlim i përhershëm i aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka të bëjë me pasojat që zakonisht ngelin pas këtyre lëndimeve siç janë: kokëdhimbjet e shpeshta të kokës, ankthe gjatë gjumit, nervozizmi me i shprehur te këta të lëndura, pagjumësia, humbje interesimi për ngjarjet në rreth, shpërqendrimi gjatë punës qoftë ajo punë fizike apo punë intelektuale, pengesa në mbajtje mend e deri te ndërrimet e personalitetit. 3. Dhimbja fizike, si pasojë e këtyre lëndimeve nga momenti i dëmtimit trupor në QE-Ferizaj e më pas në QE-Prishtinë, trajtimit hospitalor dhe jashtë spitalor-ambulator, kohëzgjatjes së shërimit, terapisë fizikale, dhimbjet fizike të përjetuara kanë qenë a. Dhimbje të intenzitetit posaçërisht të lartë rreth 1 orë, b. Dhimbje të intenzitetit të lartë për 24 orë sidomo sdhimbje të kokës dhe qafës, c. Dhimbje të intenzitetit të mesëm për 6 javë të tjera, d. Dhimbje të intenzitetit të ulët kanë qenë dhe janë prezente edhe më tej, të përcjellura me dhimbje të herpashershme të kohës, sidomos gjatë sforcimeve fizike, qëndrimit më të gjatë në diell etj. 4. Shëmtimi trupor – nuk ka pasur. 5. Përkujdesja dhe ndihma nga personi i tretë. Për shkak të lëndimeve që ka pësuar si kohëzgjatjes së qëndrimit në spitale (afërsisht 8-9 ditë), i lënduari ka pasur nevojë për përkujdesje të pandërprerë gjatë ditës nga personi tjetër për 10 ditë. Kurse si ndihmë dhe përkujdesje e përkohshme gjatë ditës, ka pasur

nevojë edhe për një periudhë prej 4*4 javëve të tjera që ka nënkuptuar ndihmën në mbajtjen e higjienës, veshmbathjes, ushqimit si dhe në dërgimin e të lënduarit në kontrollat e nevojshme mjekësore. 6. Ushqimi i përforcuar, për shkak të lëndimeve të marra ka pasur nevojë për ushqim të pasur me protein, vitamina, minerale në kohëzgjatje prej 6 javëve, ushqim i pasur me protein, prodhime të qumështit, minerale, vitamina etj. Në kuptim rritjes së imunitetit dhe përforcimit të organizmit në tërësi pas lëndimit të pësuar – rehabilitimit më të shpejtë. 7. Për shkak të rehabilitimit më të shpejtë nga lëndimet e marra i lënduari ka pasur nevojë për rehabilitim në ndonjë qendër rehabilituese 2 x 10 ditë në vitin e parë dhe në vitin e dytë pas lëndimit.

Gjykata duke u bazuar në Fletëlëshimin me Epikrizë, nr. amëz ..., gjeti se paditësi ka qëndruar në QKUK-Klinika e Neurokirurgjisë nga dt. ...-....., si pasojë e lëndimeve të pësura në vendin e punës.

Eksperti Dr. M.A – psikiatër, në ekspertizën e tij ka konstatuar se si pasojë e ramjes nga lartësia dhe lëndimit në vendin e punës te J.C është manifestuar: Frikë primare të intensitetit të lartë disa sekonda, që është manifestuar me frikë nga përfundimi fatal; Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 10 ditë, që është manifestuar me gjendje të përgjumur, me gjendje të turbulluar, me ankthe gjatë natës etj., Frikë sekondare e intensitetit të mesëm, që ka zgjatur tre javë, të manifestuara me ankthe të natës por më të rralla, agresiv me rrethin ku jeton, brengosje për gjendjen shëndetësore etj., Frikë sekondare të intensitetit të ulët edhe një muaj, të përcjellura me ankthe gjatë natës, nervoza, por me më të rralla etj.

Gjykata ja fali besimin e plotë ekspertizës mjekësore të punuar nga ana e ekspertëve ortopedë gjyqësorë dhe psikiatër edhe atë dr. Enver Ismaili dhe dr. M.A, kjo për faktin se e njëjta është arsyetuar mjaftueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat, Gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Ekspertiza për mbrojtje dhe siguri në punë e nxjerrë në këtë çështje kontestimore, ka ofruar të dhëna lidhur me përgjegjësinë e ndarë të palëve ndërgjyqëse në përpjesëtim me veprimet që ka qenë dashur t'i ndërmarrin. Gjykata e ka pranuar ekspertizën në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar. Gjykata ja fali besimin e plotë ekspertizës nga mbrojtja dhe siguria në punë të Dr. sc. H.O, të datës kjo për faktin se e njëjta është arsyetuar mjaftueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme. Nga kjo ekspertizë është vërtetuar baza

juridike e kërkesëpadisë së paditësit, lidhja kauzale–shkakore në mes veprimit të paligjshëm – aksidentit në punë, dhe pasojës së shkaktuar - lëndimeve trupore të paditësit. Pra, ekspertiza nga mbrojtja dhe siguria në punë ka vërtetuar faktin se përgjegjësia primare i takon punëdhënësit kurse përgjegjësia sekondare i takon punëmarrësit J.C. Eksperti ka qenë në tërësi i paanshëm gjatë dhënies së mendimit të tij, i njëjti i ka shfrytëzuar shkresat e lëndës C.nr....., materialin e dërguar nga pala e paditur, deklarata e palës paditëse, ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë, ligjin e punës, rregulloren nr. për vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën. Eksperti i ka listuar 10 shkelje në total, 9 shkelje i adresohen punëdhënësit, 1 shkelje i adresohet punëmarrësit dhe mbi këtë bazë gjykata ka vendosur që ta ndan përgjegjësinë e palëve në shkallën prej 90% te punëdhënësi dhe 10% te punëmarrësi, duke u bazuar në ekspertizën nga mbrojtja dhe siguria në punë.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 (LMD) e rregullon çështjen e kompensimit të demit. Neni 154 i LMD-së, thotë: Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. Ndërsa neni 5, par. 1 i Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, përcakton se: Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurt dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. Kurse neni 6 par. 1 rregullon se: Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.

Gjykata përmes provave të administruara të cilat dërguan në gjendjen faktike të vërtetuar, gjeti se palët ndërgjyqëse mbahen përgjegjëse për shkaktimin e dëmit në këtë rast kontestues, në përpjesëtim me lëshimet e tyre, kjo ngase lëndimi i paditësit në vendin e tij të punës ka ardhur si pasojë që i njëjti nuk ka pasur kujdes të duhur për sigurinë dhe shëndetin e vet gjatë kryerjes së detyrave, edhe pse nuk ka pasur vlerësim të rrezikshmërisë dhe përshkrim të detyrave të punës (neni 21, par. 4 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).

Gjykata gjeti se e paditura nuk ka respektuar obligimet ligjore të parapara me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të cilat u elaboruan, ndërsa gjykatës nuk i ofroi prova që do të dëshmonin se e paditura nuk mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit, e që do të kishin si

pasojë lirim nga përgjegjësia të paditurës. Kurse, në anën tjetër u gjet se e paditura ka dështuar në ndërmarrjen e masave preventive sipas nenit 18 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Gjykata vë në dukje se tek rastet e dëmit jashtë kontraktual duhet të plotësohen disa kushte siç janë: a) ekzistenca e dëmit, b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) ekzistenca e fajit (me dashje apo nga pakujdesia), dhe d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Rrjedhimisht, tek rasti kontestues është përmbushur elementi i lidhjes kauzale apo shkakore, që tërheq pas vetes edhe fajin më pastaj përgjegjësinë. Gjykata vlerëson se tek ky rast përmbushen elementet e lidhjes shkakore që paraqet raportin e ndërsjellët ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra, lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Çdo ngjarje që është kusht për dëmin, d.m.th., pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron të paditurin të shpërblej dëmin. Së këndejmi lidhja kauzale duhet të jetë e atillë që duhet të dëshmojë për ngjarjen e cila sigurtë është shkaktuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit të personi. Përfundimisht, në këtë proces kontestimor, pala e paditur nuk arriti të argumentojë se ka ndërmarrë masat preventive.

Gjykata vlerëson se nga administrimi i provave gjatë shqyrtimit kryesor, me theks të veçantë ekspertizës për mbrojtje dhe siguri në punë, gjeti se edhe paditësi me veprimet e tija ka pjesëmarrje në dëmin e shkaktuar, së këndejmi është arritur deri tek gjendja faktike e vërtetuar se kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë. Sipas nenit 21, par. 1 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë: Çdo i punësuar ka përgjegjësi të përkujdeset për sigurinë dhe shëndetin e vet dhe të personave të tjerë në punë, në përputhje me trajnimin dhe udhëzimet që i janë dhënë nga punëdhënësi. Në kuptim të kësaj dispozite gjykata gjen se paditësi është dashur të jetë më i kujdesshëm gjatë kryerjes së detyrave të tij të punë. Rrjedhimisht me rastin e caktimit të lartësisë së kompensimit të dëmit për bazat e gjuara, gjykata pati parasysh edhe faktin e përgjegjësisë së ndarë të këtu palëve ndërgjyqëse dhe kontributin e tyre në shkaktimin e aksidentit. Kështu që nisur nga kjo rrethanë vendosi të bëjë ndarjen e përgjegjësive në shkallën 90 % për të paditurën si punëdhënëse dhe 10 % për paditësin si punëtor, duke u bazuar në ekspertizën për mbrojtje dhe siguri në punë, të cilës gjykata ja fali besimin, e sipas të cilës edhe nga ana e paditësit ka pasur lëshime sekondare.

Sa i përket përgjegjësisë së ndarë gjykata ka aplikuar dispozitën e nenit 176, par. 1 të LMD-së sipas të cilit i dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar. Gjykata vë në dukje se tek rastet e përgjegjësisë së ndarë, shkaktuesi i dëmit – e paditura duhet të ofrojë prova lidhur me kontributin e paditësit, kurse në anën tjetër, palës paditëse i takon barra e provës për të përcaktuar kontributin e të paditurës, ashtu siç edhe u vlerësua, me provat e administruara në këtë procedurë gjyqësore, provat dërguan që gjykata të arrijë deri tek një gjendje faktike e vërtetuar të përgjegjësisë së ndarë në atë primare dhe sekondare.

Gjykata vlerëson të theksojë se me rastin e caktimit të lartësisë së kompensimi për secilën kategori të dëmit, është konsideruar se paditësi kishte pasur pjesëmarrje në kuptim të përgjegjësisë për rritjen e vëllimit të dëmit në lartësi 10%, pra përgjegjësia e paditësit shprehet në 10% ndërsa përgjegjësia e të paditurës me 90%, konform shkeljeve të evidentuara në ekspertizën për mbrojtje dhe siguri në punë. Prandaj, shumat e gjithmbarshme të kompensimit janë refleksion i zbritjes së tyre në kuptim të asaj përqindje.

Në rastin konkret, në bazë të të gjitha provave të administruara, e në kuptim të dispozitave të lartëcituar, rezulton se paditësi, si pasojë e aksidentit në vendin e punës të dt. 15.12.2018, ka pësuar dëm jo material (i cili konsiston në dhimbje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor), si dhe dëm material, (i cili konsiston në nevojën për ndihmën e personit të tretë, ushqim të përforcuar). Kategoritë e lartëcekura të dëmit të pësuar, përfshirë edhe intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre janë të specifikuar në ekspertizën mjekësore, të punuar nga ekspertët Dr. Enver Ismaili dhe Dr. M.A. Të gjeturat e kësaj ekspertize janë elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktgjykimi dhe këto të gjetura nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit kryesor. Krahas vërtetimit të faktit se paditësi ka pësuar format e lartëcekura të dëmit, buron edhe detyrimi i të paditurës për shpërblimin e të njejtit. Bazuar në natyrën e dëmit të pësuar, rivendosja e gjendjes së mëparshme për paditësin është e pamundur, andaj shpërblimi i dëmit mund të realizohet përmes caktimit të detyrimit të të paditurit për pagesën e një shume të të hollave.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi që në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të dëmit jo material, për dhimbjet fizike të përjetuara ta detyrojë të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 4,000€, duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve të konstatuara nga ekspertiza mjekësore.

Në emër të dëmit jo material për frikën e përjetuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 2,000 Euro, po ashtu duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar nga aksidenti, të specifikuar në ekspertizën e psikiatrisë.

Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën 5%, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 3,200€.

Lidhur me shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material, Gjykata iu referua edhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, 41/2023, të dt.27.02.2023, me të cilin janë përcaktuar disa kriteret orientuese lidhur me lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material.

Në raport me dëmin material, Gjykata e detyroi të paditurën që në emër të ndihmës së personit të tretë, t'ia paguajë paditësit shumën prej 150,00 Euro, duke marrë për bazë se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se kohëzgjatja e nevojshme e kësaj ndihme përkon në periudhën ditore prej 4 javëve, konform nenit 323 të LPK.

Sa i përket nevojës për ushqim të përforcuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 250,00 Euro, marrë parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar që paditësi si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 6 javëve, konform nenit 323 të LPK.

Gjykata sjellë në vëmendje faktin se për këto dy kategori të dëmit material (ndihma e personit të tretë dhe nevoja për ushqim të përforcuar), ndonëse ka qenë e mundur që të argumentohet që kanë ardhur në shprehje me rastin e shkakimit të dëmit, në praktikë është dukshëm e vështirë për tu argumentuar nga ana e paditësit lartësia e saktë e shpenzimeve të krijuara përmes prezantimit të provave materiale. Në këtë kuptim, është përcaktuar një standard që duhet vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të Gjykatës, me rastin e vendosjes së një shpërblimi adekuat për këto lloje të dëmit.

Mbi këtë bazë, Gjykata në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke gjykuar shumat e specifikuara në këtë pikë të dispozitivit, me bindjen se në raport me dëmin material të pësuar, shumat e tilla janë të nevojshme për ta kthyer gjendjen materiale të të dëmtuarit - këtu paditësit në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë para se të shkaktohej dëmi. Sa i përket dëmit jo material, Gjykata vlerëson se shumat e gjykuara paraqesin një lloj satisfakcioni moral në raport me cenimin që i është bërë paditësit, ndërsa me rastin e

vendosjes lidhur me këtë kërkesë është marrë në konsideratë rëndësia e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim se kompensimi i gjykuar nuk guxon të paraqet qëllime lukrative (fitimprurëse). Njëherit me rastin e caktimit të shumave të gjykuara Gjykata ka marrë për bazë karakteristikat personale të paditësit si dhe këto shuma i ka bazuar në praktikën e gjykatave në Kosovë, lidhur me caktimin e lartësisë për dëmin jo material dhe material.

Arsyet mbi refuzimin e pjesërishëm të padisë

Gjykata në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit përtej shumave të gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: shumën prej 3600,00€ në emër të dhimbjeve fizike, në emër të frikës shumën prej 800,00 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 1800,00€ si dhe kërkesa lidhur me kompensimin e shpenzimeve të rehabilitimit klimaterik, shumën prej 690,00€.

Kjo për faktin se çfarëdo shume e gjykuar përtej asaj që i është njohur paditësit në emër të kompensimit të këtyre formave të dëmit, nuk do të ishte në proporcion të plotë me intensitetin apo vëllimin e dëmit të pësuar dhe do ta tejkalonte qëllimin të cilit i shërben një shpërblim i tillë. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se qëllimi i realizimit të kërkesës për kompensim nuk ka të bëjë me pasurimin e palës e cila e ka parashtruar kërkesën, por me kthimin e një gjendje e cila ka qenë para shkaktimit të dëmit, respektivisht ofrimin e një satisfakcioni moral për palën e dëmtuar në raport me të mirat që i janë cenuar.

Sa i përket kërkesës për shpenzimet e rehabilitimit fiziko-terapeutik, në lartësinë prej 690,00€, gjykata vlerëson se duhet të refuzohet kjo kërkesë si e pathemeltë, për faktin se edhe pse me ekspertizën e ortopedisë, është përcaktuar se pala ka pasur për nevojë rehabilitim fiziko-terapeutik 2x10 ditë, mirëpo paditësi nuk i ka sjellur gjykatës prova materiale përkatësisht fatura valide se e ka pranuar rehabilitimin fiziko-terapeutik. Andaj për këtë pjesë kërkesa refuzohet, duke qenë se paditësi e ka pasur barrën e provës konform nenit 7, 319 dhe 322 të LPK, ndërsa gjykatës nuk ja ka vërtetuar faktin se e ka pranuar rehabilitimin fiziko-terapeutik.

Vendimi lidhur me kërkesat aksesore

Është vendosur që e paditura t'ia paguajë paditësit kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt. 09.10.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material, do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.

26.02.2019, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së.

Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për të dy format e dëmit (jo material dhe material) iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata e mbështeti në dispozitat nga nenet 452, 453, lidhur me nenin 463.1 të LPK në lidhje me TOAK, vlera e kontestit e përcaktuar me këtë aktgjykim 9600,00€, duke e obliguar të paditurën që paditësit, t’ia kompensojë shumën e shpenzimeve të nevojshme dhe të domosdoshme të krijuara deri në këtë fazë të procedurës sipas kërkesës së specifikuar në vlerë të përgjithshme prej 1380,00 Euro dhe atë: shumën prej 104,00 Euro në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 100,00 Euro në emër të taksës gjyqësore për padi, në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizës mjekësore të ortopedisë shumën prej 150,00€, në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizës së psikiatrisë shumën prej 150,00€, në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizës nga mbrojtja dhe siguria në punë shumën prej 200,00€, si dhe shumën prej 676,00 Euro për përfaqësim në 5 (pesë) seanca gjyqësore të mbajtura secila nga 135,2€, edhe pse në fakt janë mbajtur 7 (shtatë) seanca por gjykata është kufizuar konform nenit 2 të LPK vetëm brenda kërkesës së palës. Kurse shpenzimet për përpilimin e parashtresës për precizim të padisë në shumën prej 260,00€ janë të pabazuara për arsye se kjo parashtresë nuk hyn në grupin e parashtresave për të cilat paguhet kompensimi.

Lidhur me shpenzimet e aprovuara gjykata i është referuar nenit 453 të LPK, i cili parasheh që: “453.1 Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat. 453.2 Po që se është parashikuar tarifa për shpërblimin e avokatëve, apo për shpenzimet tjera, atëherë këto shpenzime do të matën sipas tarifës së tillë.”.

Bazuar në të lartëcekurat, në mbështetje të dispozitës së nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2024:073916, datë 09.10.2024

G j y q t a r i,

Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.